

UDHËZIM
Nr. 12, datë 19.7.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 749, DATË 28.12.1999 “PËR TRANSPORTIN
RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës; në zbatim të nenit 63 të kapitullit 5 të ligjit nr. 8303, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”; të shkronjës “a” të pikës 9.7 dhe pikës 9.8 të kapitullit IX të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 21.8.1998 “Për rregullat e klasifikimit, emërimit dhe transportimit rrugor të mallrave të rrezikshme”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 749, datë 28.12.1999 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“Mjetet me motor, rimorkiot, gjysmërimorkiot për transportin e disa mallrave të rrezikshme kalojnë kontrollin për gjendjen teknike që kryhet në DPSHTRR, sipas udhëzimit nr. 5, datë 28.3.1999 “Për ekzaminimin e mjeteve dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR.”.

2. Paragrafi i dytë i pikës 2 riformulohet si më poshtë:

“Certifikata mod. 013 që lëshohet nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT), veç të tjerave përmban rezultatet e inspektimit fillestar ose inspektimit periodik, ose inspektimit të ndërmjetëm, ose kontroleve të veçanta, siç përmendet në Standardin European SSHEN 12972:2007 dhe kontrollit të provës siç përmendet në pikën 5.9.3 të urdhëresës nr. 1, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave, për rastin e mjeteve-cisternë, cisternave të çmontueshme, cisternave të transferueshme etj.”.

3. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

“Kontrolli i mjetit konsiston në verifikimin e plotësimit të kushteve teknike për efekt të sigurisë në rrugë, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 5, datë 28.3.2012. Kontrolli kryhet në përputhje me urdhëresën nr. 1, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave dhe pjesën 9 të ADR-së.”.

4. Pika 8 riformulohet si më poshtë:

“Një kopje e certifikatës mod. 013 dorëzohet nga subjekti në organin kompetent të dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”.”

5. Në pikën 9, togfjalëshi “sipas modelit 012 bashkëngjitur këtij udhëzimi” zëvendësohet “sipas modeleve nr. 213 dhe 214 të udhëzimit nr. 20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”.

6. Modeli nr. 013 për cisternat, bashkëlidhur udhëzimit nr. 749, datë 28.12.1999, ndryshohet me modelin nr. 013, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi